

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ Innovation Energy“ sh.p.k**

Ne Elbasan, sot me date 21/02/2022 (njetete e nje, shkurt, dy mije e njetete e dy), u paraqit personalisht ortaku themelues: **Altin Toska, i biri Bardhyl, datelindja 23/06/1976**, lindur ne Shtermen, Cerrik me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr. personal Leternjoftim 036346495, banues në Shtermen, Cerrik

Deklaroj me vullnetin tim te plote e te sinqerte dhe me iniciativen time te lire dhe private mbështetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim **“Innovation Energy” sh.p.k**

**KREU I**  
**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**


Shoqeri e cila do te merret me Ndertimin, investimin, rikonstrukcionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa kanalizime, rrugeve, veprave te ndryshme te artit ne fushen e ndertimit etj. Importimi dhe eksportimi dhe tregtim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme industriale. Prodhim, Import-Eksport, tregtim, furnizim i energjise elektrike, energjise diellore dhe energjise nepermjet eres. Importim, eksportim, tregtim, montim impjante e paneleve diellore dhe paisje e materiale qe lidhen me funksionimin e impianteve apo paneleve me energji diellore. Projektim e zbatim i impjanteve e paneleve diellore .

**Neni 1**  
**Emertimi**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte **“ Innovation Energy “ sh.p.k**

**Neni 2**  
**Forma Juridike**

Shoqëria **“Innovation Energy “ sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaket e shoqerise, te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.  
Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.



**Neni 3**  
**Selia**

**Selia** e Shoqerise eshte Rruga: Toskalli nr. 10/2 Shtermen, Cerrik, zona kadastrale 3422, nr. pasurise 120/23

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarise**

Shoqeria do te kryejë aktivitetin e meposhtem (vetem nese eshte i përcaktuar)

Ndertimin, investimin, rikonstruksionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa kanalizime, rrugeve, veprave te ndryshme te artit ne fushen e ndertimit etj. Importimi dhe eksportimi dhe tregtim me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme industriale. Prodhim, Import-Eksport, tregtim, furnizim i energjise elektrike, energjise diellore dhe energjise nepermjet erez. Importim, eksportim, tregtim, montim impjante e paneleve diellore dhe paisje e materiale qe lidhen me funksionimin e impianteve apo paneleve me energji diellore. Projektim e zbatim i impjanteve e paneleve diellore .

**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpjtuar te shoqerise ose zgjatja e afatit, duhet te behet me vendim te Ortakëve të Shoqërisë.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë (njqind mije leke). Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre .

Personat qe zotërojne 100% të kapitalit në shoqëri jane:

100% të kapitalit në shoqëri i zoteron ortaku i vetem **Altin Toska**.

Kapitalit i korespondojne 1 kuote me vlere 100.000 leke (njqind mije) .



Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesisë mbi kuoten si dhe kushtet e tjera te kalimit ,përfshire momentin e pageses se çmimit ,rregullohen nga kontrata . Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort ne kontrate, vlefshmeria kalimit te titullit te pronesisë mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ , përfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit”.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Ortaket e shoqerise jane përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimindhezhvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për ceshtje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- f) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 10** **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:


**Administratori i shoqërisë do të jetë Altin Toska , lindur më 23/06/1976, në Shtermen, identifikuar me nr. personal Letërnjoftimi 036346495**

### **Neni 11**

#### **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të



**Innovation Energy sh.p.k.**

**Adresa: Rruga: Toskalli nr. 10/2 Shtermen, Cerrik**

**Email: innovationenergy.al@gmail.com**

---

shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërbllimin e administratorit në baze të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 12**

### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 13**

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblese së Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 14**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë akt themelimin statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 15**

#### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i vetëm i shoqërisë si themelues i saj pasi e lexoi me vëmendje akt themelimin e mesipër dhe duke qenë konform vullnetit të tij e firmosi pa verejtje.

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË "Innovation Energy " sh.p.k**

**Altin Toska**

